



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0588

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) dhe nenit 29 të Rregullores së Punës së OSHP-se në përbërje nga Agon Ramadani -Kryetar, Vjosa Gradinaj Mexhuani dhe Vedat Potërqi - Anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Nika Pro- Ing" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë të Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi SHFMU në Pozharan Komuna e Vitisë – vazhdimi i punimeve" me numër të prokurimit 214-22-8829-5-1-1, me 11/10/2023, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE "Nika Pro- Ing" SH.P.K. me nr. 2023/0588, e datës 16/08/2023, kurse vendimi i AK Ministria e Punëve të Brendshme, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndërtimi SHFMU në Pozharan Komuna e Vitisë – vazhdimi i punimeve" me numër të prokurimit 214-22-8829-5-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Nika Pro- Ing" SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 25.08.2022 ka paraqitur Njoftimin për kontratë B05, për aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi SHFMU në Pozharan Komuna e Vitisë – vazhdimi i punimeve" me numër të prokurimit 214-22-8829-5-1-1.

Me 04. 08. 2023, AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin vendim ka rekomanduar për dhënie të kontratës “AGG Project” & “Act Ing shpk”.

Me 09.08.2023, OE "Nika Pro- Ing" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. Ndërsa me 14.08.2023, AK – MPB, ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të Operatorit Ekonomik

ankues si të pabazuar.

Operatori ekonomik "Nika PrO- Ing" SH.P.K i pakënaqur me Vendimin e AK-së për anulim, me 16.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokollit 588/23.

Për këtë procedurë të prokurimit janë marrë vendimet me numër protokollit: PSh.Nr. 569, 579/22 i datës 17. 01. 2023, PSh.Nr. 74/23 i datës 25. 07. 2023.

- Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 27.07.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Eksperti shqyrtues nuk mund të jap rekomandim për vendimin e AK pasi veç ekziston një vendim i panelit shqyrtues.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet pjesërisht me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave -

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtruesit e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

Përgjigjet e AK-së lidhur me pretendimet ankimore në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim

- Përgjigje për pretendimin ankimor së janë bërë shkeljet të Neni 39 i RRUOPP-se, Sqarimi i tenderit, Autoriteti Kontraktues, në përputhje të plotë me këtë nen dhe nenet 59 dhe 72 të LPP-së ka bërë, kërkesë për sqarime shtese nga OE i rekomanduar për kontratë me datën 02.08.2023 dhe me datën 04.08.2023 AK ka pranuar sqarimet e kërkuara, sqarimet janë në pajtueshmëri të plotë me LPP-së dhe aktet tjera nën ligjore mbi prokurimin publik në Republikën e Kosovës dhe pretendimi i juaj së OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm nuk qëndron, sepse OE ankues nuk ka specifikuar së në cilat pika OE i rekomanduar për kontratë është i pa përgjegjshëm, ky pretendim ankimor nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. Autoriteti Kontraktuese -Ministria e Punëve të Brendshme-ZPP dhe komisioni i ri - vlerësimit ka vepruar në harmoni të plotë me Vendimin e OSHP-së me nr.2023/ 0074 dhe rregullativën ligjore mbi prokurimi publik në Republikën e Kosovës duke trajtuar në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim të gjithë OE-të palë në këtë proces: Udhëzues Nr.001/2023 për Prokurimin Publik neni 10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve dhe Neni 30 Validiteti i Tenderit pika:

30.4 Në situata të justifikueshme dhe/ose të veçanta kur vonesa të papritura shfaqen, duke nënkuptuar që procesi i vlerësimit nuk mund të finalizohet brenda afatit të periudhës së validitetit të tenderëve për arsye të detajeve komplekse teknike të sqaruara, AK do të kërkoj nga OE të zgjasin validitetin e tenderëve të tyre. Kërkesa për zgjatje të validitetin të tenderit do të bëhet me shkrim dhe duhet të kërkohet para datës së skadimit dhe duhet të ngritet në sistem (është e rëndësishme të verifikohet që të gjithë tenderët pranojnë kërkesën për zgjatjen e validitetit të tenderit)

30.5 Në përputhje me rrethanat, nga të gjithë tenderët do të kërkohet që gjithashtu të zgjasin validitetin e sigurimit të tenderit të tyre.

30.6 Është e hapur për secilin OE të vendos nëse dëshiron të zgjatë validitetin e tenderit. OE të cilët vendosin të mos zgjasin validitetin e tenderëve të tyre do të refuzohet si "të papërgjegjshëm" dhe kështu AK nuk do të konfiskoj Sigurimin e Tenderit të tyre. Me datë 13.04.2023 AK ka kërkuar nga OE-të palë në këtë AK përmes B47 - Letër Standarde e kërkesës për sqarimin e tenderit Vazhdimin e validitetit të tenderit për 90 ditë dhe vazhdimin e sigurimit të tenderit për 120 ditë është e qarë edhe në dokumentin e lartë cekur së kur dhe si duhet të dorëzohet dokumentacioni i kërkuar citat "*Dorëzimi i vazhdimit të validitetit të tenderit, duhet të pranohen prej Ju në adresën elektronike përmes platformës së E-prokurimit (Dorëzimi i dokumenteve në AK). Pa përgjigjen nga ana e juaj në pyetjet e lartë shënuara brenda 5 dite, tenderi juaj do të refuzohet.*" mbyll citatin.

- AK-MPB, ka vepruar në harmoni të plotë me nenet e lartë cekuar sepse kurë është kërkuar vazhdimi e keni pasur të sqarua në Letër standarde dorëzimin e dokumentacionit ndërsa kur keni ber kërkesë për qasje në dokumente ju është sqaruar se si duhet të veprohet dhe pretendimi për standarde të dyfishta nuk qëndron dhe refuzohet i pa bazuar. AK edhe një herë ju sqaron së ju jeni palë pa interes juridiko material sepse oferta e juaj është dukshëm me e lartë së oferta e rekomanduar për kontratë nga AK-MPB. Në zbatimin të, Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve, Ministria e Punëve të Brendshme nxjerrë këtë përfundim:

Pretendimet e Ankuesit “Nika PrO Ing”

OE ankues i pa kënaqur me përgjigjen e pranuar nga AK të datës 14. 08. 2023 parashtrohet ankesë në OSHP me pretendimet se AK ka shkelur nenin: Neni 1, 6, 7, 59, 60, 69, 72 i LPP-së.

- *Pretendimi i parë (1).* Te na njihet se kemi validitet (dëshmitë e-mail dhe sigurimet e deklaratat)
- *Pretendimi i dytë (2).* GOE “AAG Projekt SH.P.K; AC ing SH.P.K; Euro Services Sh.P.K. nuk është i përgjegjshëm pasi nuk ka ofruar makinerinë e ofruar është i pa përgjegjshëm edhe sipas vendimit të parë të OSHP-se me nr 569/22 dhe 579/22 prape është konstatuar me vendimin e dytë të OSHP-se nr 2023/0074. Qe nuk i ka plotësuar kërkesat sipas DT.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Pretendimi i parë ankimor ka të bëjë vazhdimin e validitetit, ku sipas AK-së OE ankues nuk ka bërë vazhdimin e validitetit. Pas analizimit të ankesës kemi hasur në dëshmi se OE ankues përmes emailit ka dërguar vazhdim të validitetit mirëpo jo edhe përmes platformës së E-Prokurimit.

Gjatë analizimit të shkresa të lëndës nuk gjetur dëshmi se AK e ka njoftuar OE se vazhdimi i validitetit përmes emailit është i papranueshëm, andaj vlerësojmë se pretendimi ankimor në këtë pikë është i bazuar. Sa i përket pretendimeve kundrejt OE të rekomanduar për kontratë se i njëjti është i papërgjegjshëm, sqarojmë se kjo ka qenë i objekt i shqyrtimit përmes ankesës 74/23, për të cilën kemi dhënë përgjigje dhe raportin e ekspertizës, si dhe është lëshuar vendimi i OSHP-së 74/23.

Vlen të ceket se me vendim të OSHP-së nuk është konstatuar se OE në atë rast ankues ka qenë i papërgjegjshëm.

Krejt në fund theksojmë se dallimi në çmim mes OE tani ankues, dhe OE tani të rekomanduar është për rreth 200,000.00€ me çmim më të ulët.

Konstatimet e Panelit Shqyrtues

Me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e Operatorit Ekonomik ankues dhe Autoritetit Kontraktues, dhe gjeti se ankesa e parashtruar nga OE “Nika PrO Ing” për procedurën e prokurimit të sipërcituar, është pjesërisht e bazuar.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK nuk përkojnë me tiparet themelore të LPP-së, që janë efikasiteti, trajtimi i barabartë i palëve, ekonomiciteti e poashtu duke konsideruar natyrën e këtij karakteristikat e këtij aktiviteti, të gjitha këto rrethana kanë ndikuar që PSH të arrije në konstatimin që zgjidhja më e mirë do të ishte që aktiviteti të kthehet në rivlerësim duke vërtetuar gjendjen faktike konform legjislacionit në fuqi në relacion me pretendimet ankimore të paraqitura në ankesë.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve

ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se për këtë procedurë të prokurimit është marrë vendim nga paneli shqyrtues i OSHP-së me numër protokoli 74/23 ku paneli shqyrtues e ka obliguar AK-në që gjatë rivlerësimit të zbatoj dispozitat ligjore të LPP-së, duke vërtetuar pretendimet ankimore konform neneve 72 si dhe 59 të LPP-së, parimisht duke u bazuar në interesin të përgjithshëm dhe kategorisë së ndjeshme që aktiviteti i prokurimit ka të bëjë me ndërtimin e shkollave që ndërlidhet me arsimimin e fëmijëve si dhe duke trajtuar të gjithë OE-të pjesëmarrës në mënyrë të barabartë duke qenë se ekspertiza e fundit kishte paraqitur fakte argumente dhe hulumtime të reja në krahasim me ekspertizën 569-579/22, me të cilën në lidhje me ekspertizën nr 74/23 eksperti kishte konsideruar se kërkesa lidhur me certifikatat plotësohet me crast AK ishte pajtuar, ndërsa lidhur me faktin që tani ankuesi ka ngritur si çështje, PSH konstaton se kjo është lënë në përgjegjësi të AK-së që të vërtetetojë përmbushjen e kriterit relevant, andaj mund të konsiderohet si çështje e gjykuar nga ana e panelit.

Sa i përket pretendimit ankimor kundrejt OE të rekomanduar për kontratë, se nuk është plotësuar kërkesa lidhur me pajisjet, konkretisht kërkesa *"Operatori ekonomik duhet të ofrojë si deshmi se posedon keto pajisje: Greder 5.2-8 ton, ndërsa OE i rekomanduar në ofertën e tij ka paraqitur, Grederin prej 10 tonëve, PSH lidhur me këtë vlerëson se pajisja e paraqitur, bazuar në raportet e ekspertizave dhe të dhënave të paraqitura deri më tani është jashtë kërkesave specifike të DT, që do të thotë jashtë kriterëve të përcaktuara në DT, megjithatë bazuar në nenin 59., paragrafi 4 i LPP-së, saktëson qartë që:*

"Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjia, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."

Kështu që përfundimisht lidhur me këtë pikë, PSH konstaton se dispozita e mësipërme specifikon qartë që "Autoriteti kontraktues" mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse përmban devijime të vogla..., andaj në këtë rast mbetet përgjegjësi të plotë të AK-së (siç edhe dispozita përcakton), që në bashkëpunim me njësinë kërkuese dhe dikasteret relevante, të vërtetojë qartë nëse pajisja e ofruar mund të konsiderohet si devijim i vogël, kjo me anë të veprimeve të ndërrmarra duke formuar një komision profesional i cili gjatë rivlerësimit do të trajtojë këtë pikë dhe të dalë me njoftim të argumentuar, të arsyetuar dhe konform dispozitës që parasheh që devijimi i tillë, nëse: *"(ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve."*

Paneli shqyrtues vlerëson se lidhur me pretendimin tjetër të ankuesit lidhur me çështjen e validitetit, PSH mbështet mendimin e ekspertit shqyrtues lidhur me këtë çështje, andaj pa nevojën për të ripërsëritur të njejtat, ky pretendim klasifikohet si i bazuar duke u mbështetur në raportin e ekspertit mbi këtë pikë.

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: “Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Paneli shqyrtues po ashtu sqaron, se autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit, ashtu siç parashihet në Nenin 6 të LPP, autoriteti kontraktues duhet të ketë në konsideratë edhe Nenin 1 të LPP, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve dhe burimeve publike si dhe Nenin 7 të LPP ku është e përcaktuar barazia në trajtim dhe jodiskriminim ku AK do t’i trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP. Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP. Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- **OE - NIKA PrO- Ing SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: